
“PI SHQIP”

Nuk është thjesht një ftesë për të shijuar një verë, por një udhëtim përmes kulturës, traditës dhe shijeve autentike shqiptare. Tek ERA kemi përzgjedhur disa nga verërat më të mira vendase, duke sjellë në tryezë kantinat dhe prodhuesit që i japin identitet verës shqiptare.

Zgjidh të preferuarën tënde dhe ngri një gotë për shijen shqiptare!



LE TË GJENDET GJITHMONË
ARSYE PËR NJË GOTË TJETËR.

OSE, PSE JO,

për një shishe të tërë...

VERË E BARDHË

LYHNID

400L

Tokai - Riesling - Muskat | 150 ml | Alc. 12.5% |
Kantina "Caco" | Pogradec, Shqipëri

Me ngjyrë të verdhë të çelët me reflektime jeshile, shfaq aroma të freskëta agrumesh, mollës, dardhës dhe lulesh të bardha, të ndërthurura me nuanca minerale. E lehtë dhe e freskët në shije, me aciditet të balancuar dhe një përfundim të pastër e të këndshëm. Shkon veçanërisht me meze tradicionale shqiptare, sallata, djathëra të bardhë dhe gatime me perime.

OAK CASK CHARDONNAY

450L

Chardonnay | 150 ml | Alc. 13% |
Kantina "Trapiche" | Mendoza, Argentina

Nga vreshta të vendosura në lartësinë 950–1200 m mbi nivelin e detit në Mendoza, kjo Chardonnay paraqet aroma dardhe, lulesh limoni, briosh dhe nuanca delikate kremi. Elegante dhe e rrumbullakët në shije, me aciditet të freskët dhe strukturë të butë nga maturimi në fuçi lisi. E përshtatshme me peshk, pasta kremoze, rizoto dhe mish të bardhë.

PROSECCO

PROSECCO EXTRA DRY

450L

Glera | 150 ml | Alc. 11% | Kantina "Tenuta SantAnna" |
DOC | Veneto, Italy

Me ngjyrë të verdhë kashte me nuanca të lehta jeshile, ofron freski dhe butësi në shije, me flluska të imëta dhe të qëndrueshme. Përfundim i këndshëm, kremoz dhe frutor. Ideale si aperitiv.

Ë ËMBËL PËR FUND VAKTI

VERË E SHENJTË

350L

Pulsi | 50 ml | Alc. 15.0% | Kantina "Nurellari" | Berat, Shqipëri

Nga varieteti autokton Pulsi, me ngjyrë të verdhë të ndritshme, shfaq aroma të mjaltit, pjeprit dhe kajsisë së pjekur. Në shije paraqet nota mjalti, rrushi të thatë dhe frutash të pjekura, me ekuilibër të këndshëm mes ëmbëlsisë dhe aciditetit. Një zgjedhje elegante për fund vakti, e përshtatshme me ëmbëlsira dhe djathëra me karakter si Gorgonzola.

VËRË E KUQE

KABERNET "ERA" — 400L

Cabernet Sauvignon - Merlot | 150 ml | Alc. 14% |
Kantina "Korça 2000" | Korçë, Shqipëri

Prodhuar ekskluzivisht për restorantet ERA, ky Cabernet paraqet një ngjyrë rubin dhe shfaq aroma të frutave të zeza, qershisë së zezë dhe kumbullës së pjekur, të ndërthurura me nuanca delikate vaniljeje dhe erëzash. E ekuilibruar në shije, me trup mesatar, tanina të buta dhe aciditet të freskët. Përfundim elegant me rikthim të frutave të errëta dhe nuanca pikante. Shoqëron me elegancë meze me salca, pasta me mish dhe gatime tradicionale me mish.

KALLMET ELEGANCE — 500L

Kallmet | 150 ml | Alc. 12.5% | Kantina "Medaur" | Koplik, Shqipëri

Nga varieteti autokton shqiptar Kallmet, me ngjyrë rubin, shfaq aroma të frutave të pyllit të ndërthurura me nuanca delikate të piperit të gjelbër. E rafinuar dhe e ekuilibruar në shije, me trup elegant, tanina të buta dhe një harmoni të këndshme mes frutave dhe strukturës. Plotëson bukur meze me salca, pasta me mish dhe kuzhinën tradicionale shqiptare.

KABERNET RESERVE "ERA" — 550L

Cabernet Sauvignon | 150 ml | Alc. 14% |
Kantina "Korça 2000" | Korçë, Shqipëri

Prodhuar ekskluzivisht për restorantet ERA dhe e vjetëruar për 18 muaj në fuçi, kjo Kabërnet Reserve shfaq një ngjyrë rubin të thellë dhe një buqetë komplekse me aroma manaferre dhe kumbulle të pjekur, të ndërthurura me nuanca vaniljeje, kakaoje, kafeje të pjekur, duhani dhe erëzash të ëmbla. E plotë dhe kadife në shije, me tanina të pjekura dhe strukturë të harmonishme nga maturimi në dru. Përfundim i gjatë dhe elegant me nota kakaoje dhe erëzash. Shoqëron në mënyrë ideale mishra të kuq, qengj, pjata tradicionale me mish dhe pasta me salca të pasura.

DANZA DELLE SPADE — 550L

Primitivo | 150 ml | Alc. 14.5% |
Kantina "Montemajor" | IGP | Salento, Italy

Me ngjyrë vjollcë-rubin, aroma delikate me nuanca botanike dhe fruta pylli. Në shije rikthehen notat e frutave të kuqe, të shoqëruara me një përfundim të këndshëm me karakterin e qershisë së pjekur. E butë dhe harmonike, me një profil elegant dhe frutor. Përshtatet bukur me antipasta me mishra, pasta me salca domateje, pizza me sallamra dhe gatime të lehta me mish.

RIESLING — 750L

Riesling | 500 ml | Alc. 12.8% | Kantina "Korça 2000" | Korçë, Shqipëri

MERLOT — 750L

Merlot | 500 ml | Alc. 13% | Kantina "Korça 2000" | Korçë, Shqipëri

VERË SHQIPTARE

VERË E BARDHË

LYHNID — 1,900L

Tokai - Riesling - Muskat | 750 ml | Alc. 12.5% |
Kantina "Caco" | Pogradec, Shqipëri

Me ngjyrë të verdhë të çelët me reflektime jeshile, shfaq aroma të freskëta agrumesh, mollës, dardhës dhe lulesh të bardha, të ndërthurura me nuanca minerale. E lehtë dhe e freskët në shije, me aciditet të balancuar dhe një përfundim të pastër e të këndshëm. Shkon veçanërisht me meze tradicionale shqiptare, sallata, djathëra të bardhë dhe gatime me perime.

DUKASI — 2,500L

Shesh i Bardhë | 750 ml | Alc. 13.0% |
Kantina "Arianiti" | Fier, Shqipëri

Nga varieteti Shesh i Bardhë, me ngjyrë të verdhë kashte të çelët me reflektime gjelbëroshe, shfaq aroma të luleve të bardha dhe agrumeve, ku dallohen limoni, frutat tropikale, dardha dhe pjeshka. E lehtë dhe e këndshme në shije, me freski, finesë dhe ekuilibër të mirë. Përshtatet bukur me djathëra të bardhë, sallata, ravioli me salca kremoze, rizoto me perime dhe mish të bardhë.

SHESHI I BARDHË — 2,700L

Shesh i Bardhë | 750 ml | Alc. 12.5% | Kantina "Arbëri" |
Rreshen, Shqipëri

Nga varieteti autokton shqiptar Shesh i Bardhë, me ngjyrë të verdhë kashte të çelët me reflektime jeshile, paraqitet e thatë dhe e këndshme në shije, me karakter të butë dhe freski të lehtë. Një verë e ekuilibruar, e menduar për t'u shijuar e freskët. Shkon veçanërisht me meze tradicionale shqiptare, djathëra të bardhë, sallata dhe gatime të lehta.

CHARDONNAY — 2,900L

Chardonnay | 750 ml | Alc. 13.0% |
Kantina "Tufa" | Tiranë, Shqipëri

Me ngjyrë të verdhë të çelët me reflektime jeshile, shfaq aroma frutash tropikale, molle, dardhe dhe nuanca agrumesh. E ekuilibruar në shije, me aciditet të gjallë, trup mesatar dhe një teksturë delikate kremoze. Përfundon pastër, me nota minerale dhe një ndjesi të këndshme freskie. Plotëson bukur mezet me djathëra, pastat kremoze, rizoton me perime dhe pulën në zgarë.

E BARDHA E BERATIT — 2,900L

Pulsi | 750 ml | Alc. 13.5% | Kantina "Cobo" | Berat, Shqipëri

Me ngjyrë të verdhë të çelët, shfaq aroma të mollës së verdhë, dardhës dhe nuanca delikate barishtore e piperi të bardhë. Në shije është frutore dhe harmonike, me nota kajsie të thatë, agrumesh dhe pjeshke, të shoqëruara me mineralitet të këndshëm dhe kompleksitet. Kombinohet bukur me djathëra të bardhë, sallata, ravioli, pasta kremoze dhe pulë të pjekur në zgarë.

PULSI

3,000L

Pulsi | 750 ml | Alc. 13.5% | Kantina “Nurellari” | Berat, Shqipëri

Nga varieteti autokton Pulsi i Beratit, me ngjyrë të verdhë të çelët me reflektime jeshile, shfaq aroma të mollës së gjelbër, grejpfrutit, kajsisë dhe agrumeve të freskëta, me nuanca barishtore. E freskët dhe e gjallë në shije, me mineralitet të këndshëm, aciditet të balancuar dhe një përfundim të gjatë me karakter lëkure limoni. Harmonizohet bukur me sallata, djathëra të lehte, rizoto me karkalec dhe gatime me perime.

MUSKAT OTTONEL

3,900L

Muskat | 750 ml | Alc. 13.5% | Kantina “Tufa” | Tiranë, Shqipëri

Nga varieteti Muskat, me ngjyrë të verdhë të çelët me reflektime jeshile, shfaq një profil aromatik elegant me nota lulesh të bardha si akacie dhe jasemin, të ndërthurura me fruta të bardha, fruta tropikale, agrume dhe nuanca delikate bimore. E rafinuar dhe e ekuilibruar në shije, me aciditet të freskët, mineralitet të këndshëm dhe një përfundim të gjatë e harmonik. Shkon veçanërisht me meze tradicionale, djathëra të freskët, gatime me perime, rizoto me karkalec dhe pjata të lehta me mish të bardhë.

Ë ËMBËL PËR FUND VAKTI

VERË E SHENJTË

3,500L

Pulsi | 500 ml | Alc. 15.0% | Kantina “Nurellari” | Berat, Shqipëri

Nga varieteti autokton Pulsi, me ngjyrë të verdhë të ndritshme, shfaq aroma të mjaltit, pjeprit dhe kajsisë së pjekur. Në shije paraqet nota mjalti, rrushi të thatë dhe frutash të pjekura, me ekuilibër të këndshëm mes ëmbëlsisë dhe aciditetit. Një zgjedhje elegante për fund vakti, e përshtatshme me ëmbëlsira dhe djathëra me karakter si Gorgonzola.

ROSÉ

SERINA ROSÉ

2,900L

Serina | 750 ml | Alc. 13.0% | Kantina “Nurellari” | Berat, Shqipëri

Nga varieteti shqiptar Serina, me ngjyrë rozë të çelët, shfaq aroma karakteristike të luleshtrydhes, qershisë së kuqe dhe nuanca delikate trëndafili. E freskët dhe e thatë në shije, me trup të mirë, mineralitet të këndshëm dhe një përfundim të qëndrueshëm aromatik. Harmonizohet bukur me antipasta, sallata, pasta të lehta dhe pica vegjetariane.

VËRË E KUQE

KABERNET "ERA"

1,900L

Cabernet Sauvignon - Merlot | 750 ml | Alc. 14% |
Kantina "Korça 2000" | Korçë, Shqipëri

Prodhuar ekskluzivisht për restorantet ERA, ky Cabernet paraqet një ngjyrë rubin dhe shfaq aroma të frutave të zeza, qershisë së zezë dhe kumbullës së pjekur, të ndërthurura me nuanca delikate erëzash. E ekuilibruar në shije, me trup mesatar, tanina të buta dhe aciditet të freskët. Përfundim elegant me rikthim të frutave të errëta dhe nuanca pikante. Shoqëron me elegancë meze me salca, pasta me mish dhe gatime tradicionale me mish.

KABËRNET RESERVE ERA

2,700L

Cabernet Sauvignon | 750 ml | Alc. 14% |
Kantina "Korça 2000" | Korçë, Shqipëri

Prodhuar ekskluzivisht për restorantet ERA dhe e maturuar për 12 muaj në fuçi lisi, kjo Kabërnet Reserve shfaq një ngjyrë rubin të thellë dhe një buqetë komplekse me aroma manaferre dhe kumbulle të pjekur, të ndërthurura me nuanca vaniljeje, kakaoje, duhani dhe erëzash të ëmbla. E plotë dhe kadife në shije, me tanina të pjekura dhe strukturë të harmonishme nga maturimi në dru lisi. Përfundim i gjatë dhe elegant me nota kakaoje dhe erëzash. Shoqëron në mënyrë ideale mishra të kuq, qengj, pjata tradicionale me mish dhe pasta me salca të pasura.

KABËRNET GRAND RESERVE ERA

3,900L

Cabernet Sauvignon | 750 ml | Alc. 14% |
Kantina "Korça 2000" | Korçë, Shqipëri

Prodhuar ekskluzivisht për restorantet ERA dhe e maturuar për 24 muaj në fuçi lisi, kjo Grand Reserve paraqet një ngjyrë rubin-vjollcë të thellë dhe shfaq një buqetë komplekse me aroma manaferre, kumbulle të tharë dhe qershie të zezë, të ndërthurura me nuanca çokollate të zezë, kafeje të pjekur, vaniljeje, duhani dhe drurit. Me trup të plotë, tanina të rafinuara dhe teksturë kadifeje, ofron një ekuilibër të shkëlqyer mes frutit dhe maturimit në dru lisi. Përfundim jashtëzakonisht i gjatë, kompleks dhe elegant. Një shoqëruese ideale për fileto viçi, mish të stazhionuar, mish qengji, mish gjahu, rizoto me tartuf, ravioli me porcini ose tartuf dhe djathëra të maturuar.

KALLMET PRESTIGJ

1,800L

Kallmet | 375 ml | Alc. 15.0% |
Kantina "Kallmeti" | Lezhë, Shqipëri

Nga varieteti autokton shqiptar Kallmet, me ngjyrë të kuqe të thellë dhe të dendur, shfaq një buqetë të pasur me aroma të qershisë së pjekur, kumbullës, kafesë, duhanit, vaniljes dhe çokollatës. E plotë dhe e fuqishme në shije, me tanina të rrumbullakosura, strukturë elegante dhe ekuilibër të shkëlqyer. Përfundim i gjatë dhe i qëndrueshëm me kompleksitet të veçantë. Një shoqëruese ideale për mishra të kuq, qengj, gatime tradicionale shqiptare, mishra të stazhionuar dhe gatime mishi të gatuara ngadalë.

KALLMET ELEGANCE

2,400L

Kallmet | 750 ml | Alc. 12.5% | Kantina “Medaur” | Koplik, Shqipëri

Nga varieteti autokton shqiptar Kallmet, me ngjyrë rubin, shfaq aroma të frutave të pyllit të ndërthurura me nuanca delikate të piperit të gjelbër. E rafinuar dhe e ekuilibruar në shije, me trup elegant, tanina të buta dhe një harmoni të këndshme mes frutave dhe strukturës. Plotëson bukur meze me salca, pasta me mish dhe kuzhinën tradicionale shqiptare.

SHESH I ZI

2,600L

Shesh i Zi | 750 ml | Alc. 14.0% | Kantina “Alimani” | Durrës, Shqipëri

Nga varieteti shqiptar Shesh i Zi, me ngjyrë rubin të errët, shfaq aroma të frutave të kuqe dhe të zeza, të shoqëruara me nuanca delikate barishtore. Në shije ofron nota qershie, kumbulle dhe manaferre, me trup mesatar, tanina të buta dhe një ekuilibër të këndshëm. Përfundim i pastër dhe harmonik. Përshtatet bukur me mishra të pjekur, gatime tradicionale shqiptare dhe pasta me mish.

MONTEMECA

3,000L

Montepulciano - Merlot - Cabernet Sauvignon | 750 ml | Alc. 14.0% | Kantina “Nurellari” | Berat, Shqipëri

Me ngjyrë të kuqe të thellë, shfaq aroma të frutave të kuqe të pjekura, qershisë, vishnjës dhe kumbullës së zezë, të ndërthurura me nuanca vaniljeje dhe një prekje delikate tymi. E plotë dhe e qëndrueshme në shije, me ekuilibër të mirë, freski dhe një përfundim të gjatë. Shoqëron me elegancë mishra të pjekur në skarë, mish qengji, pasta me salca të pasura dhe gatime tradicionale me mish.

HARMONI

3,000L

Merlot - Gems | 750 ml | Alc. 12.5% | Kantina “Caco” | Pogradec, Shqipëri

Me ngjyrë rubin të thellë me reflektime vjollcë, shfaq aroma të frutave të kuqe të pjekura, qershisë, mjedrës dhe kumbullës së zezë, të ndërthurura me nuanca vaniljeje, kakaoje dhe erëzash. E thatë dhe e plotë në shije, me tanina të buta, strukturë të mirë dhe një përfundim të gjatë e të këndshëm. E përsosur për mish viçi të pjekur në zgarë, mish derri dhe pasta me salca kremoze.

KASHMER

3,200L

Cabernet Sauvignon - Shesh i Zi - Merlot | 750 ml | Alc. 14.0% | Kantina “Cobo” | Berat, Shqipëri

Me ngjyrë rubin mesatare me reflektime granati, shfaq aroma të qershisë, boronicës së kuqe dhe nuanca delikate lëkure. Në shije ndërthuren çokollata, kërpudhat, qershia e pjekur dhe manaferra, me aciditet të balancuar, trup mesatar dhe tanina të rafinuara. Përfundim i këndshëm dhe harmonik. Rekomandohet me mish viçi, qengj, pasta me mish, gatime tradicionale shqiptare dhe djathëra të maturuar.

MERLOT RESERVE

3,500L

Merlot | 750 ml | Alc. 14.5% | Kantina “Alimani” | Durrës, Shqipëri

Me ngjyrë rubin të errët, shfaq aroma të manaferrës së pjekur, qershisë së zezë dhe nuanca delikate lëkure, vaniljeje dhe erëzash të ëmbla. Në shije është e plotë dhe kadifeje, me nota frutash të zeza, çokollate dhe druri lisi, të mbështetura nga aciditet i mirë dhe tanina të balancuara. Përfundim i gjatë dhe harmonik. Shoqëron bukur mishra të pjekur, qengj, pasta me kërpudha.

KALLMET RESERVE

3,600L

Kallmet | 750 ml | Alc. 13.5% | Kantina “Arbëri” | Rrëshen, Shqipëri

Nga varieteti autokton shqiptar Kallmet, me ngjyrë rubin të thellë, shfaq aroma të frutave të zeza të pyllit dhe shegës, të pasuruara nga nuanca elegante të maturimit në fuçi lisi. E ekuilibruar dhe harmonike në shije, me strukturë të mirë dhe një përfundim të gjatë e të qëndrueshëm. Rekomandohet me mish viçi, qengj, gatime tradicionale shqiptare dhe pasta me mish.

KALLMET PRESTIGJ

3,600L

Kallmet | 750 ml | Alc. 15.0% | Kantina “Kallmeti” | Lezhë, Shqipëri

Nga varieteti autokton shqiptar Kallmet, me ngjyrë të kuqe të thellë dhe të dendur, shfaq një buqetë të pasur me aroma të qershisë së pjekur, kumbullës, kafesë, duhanit, vaniljes dhe çokollatës. E plotë dhe e fuqishme në shije, me tanina të rrumbullakosura, strukturë elegante dhe ekuilibër të shkëlqyer. Përfundim i gjatë dhe i qëndrueshëm me kompleksitet të veçantë. Një shoqëruese ideale për mishra të kuq, qengj, gatime tradicionale shqiptare, mishra të stazhionuar dhe gatime mishi të gatuara ngadalë.

NYMPHAION SUPERIORE

5,500L

Merlot - Cabernet Sauvignon - Shesh i Zi | 750 ml | Alc. 16.5% | Kantina “Arianiti” | Fier, Shqipëri

Nymphaion Superiore, një blend i veçantë me ngjyrë të kuqe të thellë dhe intensive, shfaq një buqetë të pasur me aroma çokollate të zezë, kafeje, duhani, vaniljeje, kumbulle të pjekur dhe piper të zi. E fuqishme dhe elegante në shije, me strukturë të plotë, finesë dhe harmoni të jashtëzakonshme. Përfundim shumë i gjatë dhe kompleks, ku rikthehen nuancat e frutave të errëta, erëzave dhe maturimit në dru lisi. Një shoqëruese ideale për mishra premium të kuq, mishra të stazhionuar, qengj të pjekur ngadalë, mish gjahu dhe gatime me tartuf.



VERË INTERNACIONALE

VERË E BARDHË

PINOT GRIGIO DELLE VENEZIA — 1,350L

Pinot Grigio | 375 ml | Alc. 12.0% | Kantina "Campagnola" | DOC | Veneto, Italy

Me ngjyrë të verdhë të çelët me reflektime gjelbëroshe, shfaq aroma të freskëta agrumesh, mollës dhe dardhës. E lehtë dhe e pastër në shije, me aciditet të këndshëm dhe një përfundim të freskët e elegant. Një zgjedhje ideale për antipasta, sallata, gatime me perime dhe pjata të lehta.

GEWURZTRAMINER — 2,200L

Gewurztraminer | 750 ml | Alc. 11.5% | Kantina "Maison Castel" | IGP | Languedoc, France

Me ngjyrë të verdhë të çelët me nuanca jeshile, kjo Gewürztraminer shpalos aroma delikate lulesh dhe frutash, ku spikasin pjeshka dhe dardha. Në shije ofron nuanca frutash tropikale dhe mineralitet të lehtë, me një përfundim të freskët dhe elegant. Ideale si aperitiv, me sallata, gatime pikante pa mish, pulë në zgarë dhe perime të pjekura

OAK CASK CHARDONNAY — 2,200L

Chardonnay | 750 ml | Alc. 13% | Kantina "Trapiche" | Mendoza, Argentina

Nga vreshta të vendosura në lartësinë 950–1200 m mbi nivelin e detit në Mendoza, kjo Chardonnay paraqet aroma dardhe, lulesh limoni, briosh dhe nuanca delikate kremi. Elegante dhe e rrumbullakët në shije, me aciditet të freskët dhe strukturë të butë nga maturimi në fuçi lisi. E përshtatshme me peshk, pasta kremoze, rizoto dhe mish të bardhë.

PINOT GRIGIO DELLE VENEZIA — 2,600L

Pinot Grigio | 750 ml | Alc. 12.5% | Kantina "Zenato" | DOC | Verona, Italy

Me ngjyrë limon-jeshile, kjo verë ofron aroma të freskëta agrumesh, dardhe dhe pjeshke të bardhë. E lehtë dhe elegante në shije, me freski të theksuar, aciditet të këndshëm dhe ekuilibër të mirë. E përshtatshme me antipasta të lehta, sallata, rizoto me karkaleca dhe gatime me perime.

SAUVIGNON BLANC — 2,700L

Sauvignon Blanc | 750 ml | Alc. 12.5% | Kantina "Frigate Cove" | Marlborough, New Zealand

Me ngjyrë të verdhë limoni, kjo Sauvignon Blanc shfaq aroma të freskëta agrumesh dhe nuanca barishtore tipike të varietetit. E lehtë dhe e pastër në shije, me mineralitet të këndshëm, freski të gjallë dhe një përfundim elegant. E përshtatshme me sallata, perime të freskëta, rizoto me karkalec dhe gatime të lehta.

CHARDONNAY

2,800L

Chardonnay | 750 ml | Alc. 14% | Kantina “Silverboom” | Swartland, South Africa

Me ngjyrë të verdhë të thellë, kjo Chardonnay paraqet aroma agrumesh dhe frutash tropikale, me nota ananasi, kajsie dhe nuanca delikate gjalpi e lisi. E plotë dhe e fuqishme në shije, me aciditet të balancuar dhe një përfundim të këndshëm e të butë. Harmonizohet bukur me pasta kremoze, rizoto, pulë dhe pjata me kërpudha.

BORDEAUX BLANC

3,000L

Sauvignon Blanc - Semillon - Muscadelle | 750 ml | Alc. 12.5% | Kantina “Chateau Bellevue” | Bordeaux, France

Me ngjyrë të verdhë të çelët me reflektime kashte, shfaq aroma të freskëta limoni, grejpfruti, molle dhe dardhe, të shoqëruara me nuanca frutash tropikale. E pastër dhe harmonike në shije, me aciditet të gjallë dhe një përfundim freskues. E përshtatshme me sallata, rizoto me karkalec, pasta të lehta dhe gatime me perime.

GRECO DI TUFO

3,200L

Greco Di Tufo | 750 ml | Alc. 13% | Kantina “Lava” | DOCG | Avellino, Italy

Me ngjyrë ari limoni, kjo Greco di Tufo shpalos aroma intensive të dardhës së pjekur, mjaltit dhe bajames. Në shije dallohet për mineralitetin elegant dhe nuancat e frutave të gurta, me një freski të këndshme dhe përfundim aromatik me nota molle e dardhe. Ideale me djathëra të bardhë, sallata, pasta kremoze, rizoto me perime dhe mish të bardhë.

MALAGOUZIA

3,200L

Malagouzia | 750 ml | Alc. 13% | Kantina “Alpha Estate” | PGI | Amyndeon, Greece

Me ngjyrë të verdhë të çelët me nuanca jeshile, kjo Malagouzia paraqet aroma të freskëta agrumesh, pjeshke, dardhe dhe pjepri, të shoqëruara me nota delikate lulesh të bardha. E rrumbullakët dhe elegante në shije, me nuanca mjalti, aciditet freskues dhe një përfundim të gjatë e harmonik. E përshtatshme me sallata, gatime me perime, pasta të lehta dhe mish të bardhë.

LUCI DEL SUD

3,500L

Greco di Tufo | 750 ml | Alc. 13% | Kantina “Feudi di San Gregorio” | DOCG | Campania, Italy

Me ngjyrë ari të ndritshme me reflektime jeshile, ofron aroma të pjeshkës së verdhë, kajsisë dhe agrumeve, të shoqëruara me nuanca minerale, mjalti dhe lulesh të bardha. E plotë dhe harmonike në shije, me aciditet të gjallë dhe përfundim elegant mineral. E përshtatshme me djathëra të bardhë, pasta kremoze dhe mish të bardhë.

PINOT GRIGIO

4,000L

Pinot Grigio | 750 ml | Alc. 13.5% | Kantina “Girlan” | Italy |

Me ngjyrë të verdhë të çelët, shfaq aroma elegante të dardhës së pjekur lehtë, pjeprit, bajames dhe luleve të bardha, me nuanca delikate barishtore. Në shije është e thatë dhe harmonike, me aciditet të drejtë dhe mineralitet të rrumbullakët që i jep freski dhe finesë. E përshtatshme me sallata, rizoto me karkalec, pasta të lehta dhe djathëra të freskët.

CHABLIS

5,500L

Chardonnay | 750 ml | Alc. 12.5% | Kantina “Louis Latour” | Burgundy, France

Me ngjyrë të verdhë të çelët me reflektime të arta, kjo Chablis shpalos aroma të mollës së gjelbër, dardhës dhe luleve të bardha, me nuanca agrumesh dhe mineralitet karakteristik. Në shije është e freskët dhe harmonike, me aciditet të gjallë dhe përfundim elegant e të gjatë. Shoqëron në mënyrë ideale gatime të lehta, pasta kremoze, djathëra të freskët dhe mish të bardhë

SAUVIGNON BLANC FUMÉ

5,800L

Sauvignon Blanc 100% | 750 ml | Alc. 13% | Kantina “Alpha Estate” | PGI | Florina, Greece

Me ngjyrë të verdhë të çelët me reflektime jeshile, kjo Sauvignon Blanc Fumé shpalos një profil kompleks aromatik me nota frutash tropikale, agrumesh dhe pjepri, të ndërthurura me nuanca delikate lisi. E plotë dhe kremoze në shije, me freski, finesë dhe një përfundim të gjatë e elegant. Një zgjedhje perfekte për rizoto me karkalec, pasta kremoze, fileto salmoni dhe mish të bardhë.

ROSÉ

PINOTAGE ROSÉ

2,600L

Pinotage | 750 ml | Alc. 14% | Kantina “Silverboom” | Swartland, South Africa

Me ngjyrë rozë të ndritshme salmoni, shfaq aroma frutore të luleshtrydhes, qershisë dhe pjeshkës, të shoqëruara me nuanca delikate erëzash. Në shije është e këndshme dhe me trup të mirë, me një ëmbëlsi të lehtë, aciditet të balancuar dhe përfundim freskues. E përshtatshme për pasta me salcë domate, fileto salmoni dhe pica klasike



PROSECCO

PROSECCO MILLESIMATO EXTRA DRY

2,500L

Glera | 750 ml | Alc. 11% | Kantina “La Salute” | DOC | Veneto Italy

Me ngjyrë të verdhë të çelët me nuanca jeshile, shfaq aroma delikate lulesh të egra dhe nota frutore të freskëta. Në shije është harmonike dhe e balancuar, me freski të këndshme dhe një përfundim të gjatë e të pastër. Ideale si aperitiv dhe për shoqërimin e antipastave të lehta, sallatave dhe gatimeve të freskëta.

ARGEO PROSECCO BRUT ROSÉ

2,900L

Glera - Pinot Noir | 750 ml | Alc. 11.5% | Kantina “Ruggeri” | DOC | Treviso, Italy

Me ngjyrë rozë salmoni, kjo Prosecco Rosé paraqet aroma delikate lulesh dhe fruta të kuqe si luleshtrydhe, qershi dhe mjedër. E freskët dhe elegante në shije, me flluska të gjalla, aciditet të këndshëm dhe përfundim të pastër. Ideale si aperitiv.



VËRË E KUQE

OAK CASK CABERNET SAUVIGNON — 2,200L

Cabernet Sauvignon | 750 ml | Alc. 13.5% | Kantina "Trapiche" | Mendoza, Argentina

Nga vreshta të kultivuara në lartësi 1200 m mbi nivelin e detit në Mendoza, kjo Cabernet Sauvignon me ngjyrë rubin shfaq aroma të frutave të pyllit, të ndërthurura me nuanca delikate vaniljeje dhe çokollate. E freskët dhe elegante në shije, me aciditet të gjallë, strukturë të balancuar dhe një përfundim të këndshëm me karakter frutor. I shkon veçanërisht mishrave të pjekur në zgarë, filetos së viçit, pastave me salca të forta dhe gatimeve tradicionale me mish.

MONTEPULCIANO D'ABRUZZO — 2,400L

Montepulciano | 750 ml | Alc. 13.5% | Kantina "Velenosi" | DOC | Abruzzo, Italy

Me ngjyrë rubin të kuqe me reflektime vjollcë, shfaq aroma të freskëta të frutave të kuqe si qershia, luleshtrydhja dhe mjedra, të shoqëruara me nuanca delikate frutash të pjekura. E freskët dhe frutore në shije, me teksturë të butë e kadifeje, tanina të lehta dhe një përfundim të këndshëm. Përshtatet veçanërisht me bërxolla derri, salsiçe shtëpie dhe mishra të pjekur në zgarë.

DANZA DELLE SPADE — 2,600L

Primitivo | 750 ml | Alc. 14.5% | Kantina "Montemajor" | IGP | Salento, Italy

Me ngjyrë vjollcë-rubin, aroma delikate me nuanca botanike dhe fruta pylli. Në shije rikthehen notat e frutave të kuqe, të shoqëruara me një përfundim të këndshëm me karakterin e qershisë së pjekur. E butë dhe harmonike, me një profil elegant dhe frutor. Përshtatet bukur me antipasta me mishra, pasta me salca domateje, pizza me sallamra dhe gatime të lehta me mish.

NEGROAMARO — 2,600L

Negroamaro | 750 ml | Alc. 13.5% | Kantina "Luccarelli" | IGP | Puglia, Italy

Me ngjyrë të kuqe vjollcë të thellë me reflektime të errëta, shfaq aroma intensive të frutave të pyllit, qershisë së zezë dhe karafilit, të ndërthurura me nuanca barishtesh mesdhetare dhe çokollate të zezë. E plotë dhe e butë në shije, me strukturë të ekuilibruar, trup të mirë dhe një përfundim të gjatë e të këndshëm me karakter të pasur. Plotëson në mënyrë ideale mishra të pjekur në zgarë, pasta me salca të pasura dhe mish qengji.

MALBEC — 2,700L

Malbec | 750 ml | Alc. 13.5% | Kantina "Impernal" | AOP | Cahors, France

Me ngjyrë të kuqe vjollcë të thellë, shfaq aroma të qershisë së zezë, manaferrës dhe çokollatës së zezë. E pasur dhe e ekuilibruar në shije, me trup mesatar, aciditet të freskët dhe një strukturë të këndshme. Përfundim i plotë dhe freskues me nuanca të frutave të errëta. Shoqëron bukur mishra të kuq, mish qengji, mish të pjekur në zgarë dhe pasta me salca kremoze.

PEPE NERO

2,800L

Primitivo | 750 ml | Alc. 14% | Kantina "Cignomoro" | IGT | Salento, Italy

Me ngjyrë rubin të kuqe, shfaq aroma bujare të frutave të errëta si boronica, kumbulla dhe qershia, të shoqëruara me nuanca reçeli frutash të pyllit dhe çokollate të zezë. E ekuilibruar dhe elegante në shije, me trup të këndshëm, tanina të buta dhe një përfundim të këndshëm e të qëndrueshëm. Përshtatet veçanërisht me mishra të kuq, mishra të pjekur në zgarë, pasta me salca të pasura dhe gatime tradicionale me mish.

SHIRAZ - MERLOT SPECIAL RESERVE

2,900L

Shiraz – Merlot | 750 ml | Alc. 15% | Kantina "Silverboom" | South Africa

Me ngjyrë rubin të kuqe, shfaq aroma të manaferrës, kumbullës dhe jamballit. E plotë në shije, me fruta të errëta, nuanca reçeli frutash, vaniljeje dhe lisi. Ofron tanina të mëndafshta, përfundim të gjatë dhe një karakter të këndshëm frutor. Një zgjedhje e shkëlqyer pranë mishrave të kuq të pjekur në zgarë, mishit të qengjit dhe gatimeve me mish me salca të pasura.

CABERNET FRANC

2,900L

Cabernet Franc | 750 ml | Alc. 13% | "Tenuta Ca'Bolani" Winery | DOC | Friuli, Italy

Me ngjyrë rubin të ndritshme, aroma elegante me nota lulesh dhe fruta të kuqe të buta, të shoqëruara me nuanca jamballi dhe erëzash. E plotë dhe harmonike në shije, me tanina të buta dhe elegante. Përfundim i këndshëm dhe i balancuar. Shkon veçanërisht me mish viçi, mish qengji, pasta me salca të pasura dhe pjata me kërpudha.

CABERNET SAUVIGNON CARMENERE

3,000L

Cabernet Sauvignon - Carmenere | 750 ml | Alc. 14.5% | Kantina "Montes" | Colchagua, Chile

Me ngjyrë rubin të thellë, shfaq një profil aromatik elegant me karakter të pasur, ku spikat bujaria e Cabernet Sauvignon e harmonizuar me finesën dhe butësinë kremoze të Carmenere. E fuqishme dhe e rafinuar në shije, me tanina të mëndafshta, aciditet të balancuar dhe strukturë të plotë. Përfundim i gjatë dhe i qëndrueshëm, me një elegancë të veçantë që mbetet në shije. Përshtatet veçanërisht me mishra të kuq të pjekur në zgarë, fileto viçi, mish qengji dhe pasta me salca të pasura

BORDEAUX SUPERIOR GRAND RESERVE

3,400L

Merlot - Cabernet Sauvignon | 750 ml | Alc. 14% | Kantina "Calvet" | AOP | Bordeaux, France

Me ngjyrë nga rubin në granat, aroma të frutave të errëta me nuanca erëzash dhe kumbulle. E pasur në shije, me fruta të pjekura të errëta, nota lisi, karameleje, kafeje dhe duhani. Përfundim i këndshëm dhe harmonik me karakter të rafinuar. Plotëson në mënyrë ideale biftek viçi, brinjë të pjekura dhe pjata me kërpudha.

CHIANTI CLASSICO

3,500L

Sangiovese - Canaiolo | 750 ml | Alc. 13% |
Kantina "Carpineto" | DOCG | Tuscany, Italy

Me ngjyrë rubin të kuqe, aroma intensive të vjollcës, manaferrave dhe qershisë. E plotë dhe e ekuilibruar në shije, me nuanca lëkure, tymi dhe lisi. Përfundim i këndshëm dhe harmonik me karakter të rafinuar. Përshtatet veçanërisht me mishra të kuq, mish të pjekur në zgarë, pasta me salca mishi dhe gatime tradicionale me mish.

VALPOLICELA RIPASSO

3,500L

Corvina - Corvinone - Rondinella - Molinara | 750 ml |
Alc. 13.5% | Kantina "Costa Mediana" | DOC | Veneto, Italy

Me ngjyrë rubin të kuqe, aroma të frutave të kuqe të pjekura, qershisë, rrushit të zi dhe kumbullës. Në shije paraqitet me tanina të buta, nota rrushi të thatë, lëkure dhe erëzash. Përfundim i pasur dhe me shije të qëndrueshme. Përshtatet veçanërisht me mishra të kuq, mish të pjekur në zgarë, pasta me salca të pasura dhe gatime tradicionale me mish.

SASSEO PRIMITIVO DI SALENTO

3,700L

Primitivo | 750 ml | Alc. 14.5% | Kantina "Masseria Altemura" |
IGT | Puglia, Italy

Me ngjyrë rubin të thellë, aroma intensive të kumbullës dhe reçelit të frutave të kuqe, të shoqëruara me nuanca të ëmbla erëzash. E ngrohtë dhe e butë në shije, me fruta shumë të pjekura dhe tanina të ëmbla e të këndshme. Përfundim harmonik me karakter të pasur frutor. Një zgjedhje ideale për mishra të kuq të pjekur në zgarë, pjata me mish derri, pasta me salca të pasura dhe gatime tradicionale me mish.

MONTEPULCIANO D'ABRUZZO

3,700L

Montepulciano | 750 ml | Alc. 14% |
Kantina "Tenuta Ulisse" | DOP | Abruzzo, Italy

Me ngjyrë rubin me reflektime granati, shfaq aroma intensive dhe elegante të qershisë, manaferrës dhe frutave të kuqe, të ndërthurura me nuanca delikate lulesh. E ekuilibruar në shije, me trup mesatar, tanina të buta dhe strukturë harmonike. Përfundim i gjatë dhe i këndshëm me nuanca çokollate të zezë dhe vaniljeje. Përshtatet veçanërisht me mishra të pjekur në zgarë, pasta me salca mishi dhe pjata tradicionale me mish.

PRIMITIVO DI MANDURIA

3,900L

Primitivo | 750 ml | Alc. 14.0% | Kantina "Uone" |
DOC | Puglia, Italy

Me ngjyrë rubin të thellë, aroma të reçelit të kumbullës, frutave të kuqe dhe nuanca të lehta erëzash. Shumë e lëngshme dhe e plotë në shije, me tanina kadifeje, aciditet të integruar mirë dhe strukturë të rrumbullakosur. Përfundim i këndshëm me nota erëzash. Plotëson bukur mishra të kuq, pjata me mish derri, pasta me salca të pasura dhe gatime tradicionale me mish.

PRIMITIVO DI MANDURIA RIZERVA

4,100L

Primitivo | 750 ml | Alc. 14.5% | Kantina "Borgo Del Mandorlo" | DOC | Puglia, Italy

Me ngjyrë rubin të errët me reflektime granati, shfaq një aromë të fuqishme dhe të pasur me qershi të thartë, fruta të zeza dhe nuanca reçeli frutash. Në shije dallohen rrushi i thatë, manaferra, çokollata e zezë dhe nota elegante të drurit. E plotë dhe intensive në shije, me tanina të fuqishme, strukturë të mirë dhe një përfundim të gjatë e të qëndrueshëm. Përshtatet në mënyrë ideale me mishra të kuq të pjekur në zgarë, mish qengji, pasta me salca të pasura dhe gatime tradicionale me mish..

LAGREIN

4,200L

Lagrein | 750 ml | Alc. 13% | Kantina "Wilhelm Walch" | DOC | Alto Adige, Italy

Me ngjyrë të kuqe granati të thellë, shfaq aroma elegante të manaferrës dhe frutave të zeza. E butë dhe komplekse në shije, me tanina të rafinuara, trup të mirë dhe një teksturë kadifeje. Përfundim i plotë dhe harmonik me nuanca të frutave të errëta. Përshtatet veçanërisht me mishra të kuq, mish qengji, gatime me kërpudha dhe pasta me salca të pasura.

MONTEPULCIANO D'ABRUZZO EDIZIONE LIMITATA

4,800L

Montepulciano | 750 ml | Alc. 13.5% | Kantina "Gran Sasso" | DOCG | Abruzzo, Italy

Me ngjyrë rubin të fortë me reflektime granati, aroma intensive dhe të qëndrueshme të frutave të kuqe të pjekura, të shoqëruara me nuanca amaretto, marzipani dhe erëzash. E thatë dhe elegante në shije, me strukturë të ngrohtë dhe tanina të rafinuara. Përfundim harmonik me karakter të pasur. Përshtatet bukur me mishra të pjekur në zgarë, pjata me mish derri, pasta me salca të pasura dhe gatime tradicionale me mish.

BOURGOGNE

4,900L

Pinot Noir | 750 ml | Alc. 13% | Kantina "Louis Latour" | Burgundy, France

Me ngjyrë rubin, shfaq aroma delikate të frutave të kuqe dhe të zeza, me nuanca të qershisë dhe frutave të pyllit. E lehtë dhe elegante në shije, me tanina të buta, freski të këndshme dhe një përfundim të pastër e frutor. Shoqëron bukur mish pule, mish viçi të lehtë, kërpudha, pasta me salca të buta dhe djathëra të butë.

BAROLO

5,400L

Nebbiolo | 750 ml | Alc. 13.5% | Kantina "Ricossa" | DOCG | Piedmond, Italy

Me ngjyrë rubin të pasur, aroma të qershisë, kumbullës dhe luleshtrydhes. E plotë dhe e fuqishme në shije, me nuanca lëkure, duhani, vaniljeje dhe tone tokësore. Përfundim i gjatë dhe i pasur, me një karakter elegant dhe kompleks. Një shoqëruese ideale për fileto viçi, mishra të gatuar ngadalë, pjata me mish qengji dhe mishra të stazhionuar.

MALBEC

5,500L

Malbec | 750 ml | Alc. 13.5% |
Kantina "Catena" | Mendoza, Argentina

Me ngjyrë vjollcë të thellë, shfaq aroma të frutave të errëta, ku dallohen kumbulla, kumbulla e thatë dhe manaferra të pjekura. E pasur dhe e fuqishme në shije, me nuanca duhani, lëkure dhe vaniljeje. E ekuilibruar mirë, me tanina mesatare, strukturë të plotë dhe një përfundim elegant me karakter të maturuar. I shkon veçanërisht mishrave të kuq të pjekur në zgarë, mishit të qengjit dhe pastave me salca të pasura.

VECCHIO SOGNO PRIMITIVO DI MANDURIA

5,900L

Primitivo | 750 ml | Alc. 14.5% | Kantina "Tenuta Giustini" |
DOC | Puglia, Italy

Me ngjyrë vjollcë-rubin, aroma të frutave të zeza dhe të kuqe të pjekura, ku dallohen kumbulla, qershia e egër dhe boronica e kuqe. E pasur dhe e plotë në shije, me tanina të fuqishme, nuanca të lehta kanelle, të shoqëruara me nota të ngrohta toke dhe druri lisi. Me strukturë të mirë dhe alkool të pasur, ofron një përfundim të gjatë dhe të qëndrueshëm. Një zgjedhje ideale për mishra premium të pjekur në zgarë, veçanërisht Rib Eye dhe T-Bone dry aged, si dhe gatime mishi me shije të pasura.

EDIZIONE CINQUE AUTOCTONI

7,000L

Montepulciano - Primitivo - Sangiovese - Negroamaro - Malvasia Nera |
750 ml | Alc. 14% | Kantina "Fantini Farnese" | DOC | Abruzzo, Italy

Një blend i veçantë i pesë varieteteve autoktone italiane, me ngjyrë të kuqe granati intensive, shfaq aroma komplekse të qershisë së pjekur, kumbullës së thatë, frutave të zeza, duhanit dhe nuanca elegante të pjekjes në dru. E plotë dhe e pasur në shije, me tanina të buta e të rrumbullakosura, strukturë të fuqishme dhe një përfundim shumë të gjatë me nota vaniljeje, çokollate dhe erëzash. Plotëson në mënyrë ideale mishra të kuq të pjekur, mishra të stazhionuar, mish qengji dhe pjata tradicionale me mish

TASSINAIA

7,500L

Cabernet Sauvignon | 750 ml | Alc. 14% |
Kantina "Castello del Terriccio" | IGT | Tuscany, Italy

Me ngjyrë rubin të errët, shfaq një buqetë komplekse me aroma të frutave të zeza, rrushit të zi, barishteve aromatike, të ndërthurura me nuanca duhani, druri kedri dhe vaniljeje. E pasur dhe elegante në shije, me fruta të pjekura si kumbulla dhe qershia, tanina të buta dhe strukturë të rrumbullakosur. Përfundim i gjatë dhe harmonik me kompleksitet të veçantë. Një zgjedhje ideale pranë mishrave të kuq të pjekur në zgarë, mishra të stazhionuar dhe mishra të gatuar ngadalë.

BRUNELO DI MONTALCINO


8,900L

Sangiovese | 750 ml | Alc. 14.5% | Kantina "Banfi" | DOCG | Tuscany, Italy

Me ngjyrë rubin të shkëlqyer me reflektime granati, kjo verë DOCG nga Montalcino, një nga klasifikimet më të larta të cilësisë në Itali, shfaq një buqetë elegante me aroma të frutave të kuqe të freskëta, të ndërthurura me nuanca delikate jamballi, duhani dhe erëzash. E fuqishme dhe e rafinuar në shije, me strukturë të plotë, tanina të qëndrueshme dhe aciditet të ekuilibruar që i jep freski dhe jetëgjatësi. Përfundim i gjatë, kompleks dhe elegant. Plotëson në mënyrë ideale mishra premium të kuq të pjekur në zgarë, mish të stazhionuar, mishra të gatuar ngadalë dhe mish gjahu.

A Friend of Wine

IS A FRIEND OF MINE


www.era.al